



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 216, datë 14.12.2024

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “INFORMATIKË EKONOMIKE”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR
“BEDËR”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2024, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në **“Informatikë Ekonomike”**, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në **“Informatikë Ekonomike”**
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 248, datë 19.07.2021
- d) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Bedër”
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Bedër”
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësi si më poshtë:
 1. Mungesa e përcaktimit të numrit të krediteve të dedikuara për detyrat e kursit/projektet, në kurrikulën dhe syllabuset e këtij programi studimi.
 2. Mungesa e reflektimit të rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e mësimdhënies, në Raportin Vjetor të njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi dhe të planit të masave që ndërmerren për të promovuar rastet më të mira dhe për të adresuar problemet e ngritura.





Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Bachelor në **“Informatikë Ekonomike”**, të Kolegjit Universitar **“Bedër”**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **5 (pesë)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **13.12.2029**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar
INDRIT HOXHA		Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 216, datë 14.12.2024, “Për akreditimin e parë të programit të studimit Bachelor në “**Informatikë Ekonomike**”, të **Kolegjit Universitar “Bedër”**, janë si vijon:

1. Institucioni, të përcaktojë numrin e krediteve të dedikuara për detyrat e kursit/projektet, në kurrikulën dhe syllabuset e këtij programi studimi, si edhe të shohë mundësinë e shtimit të numrit të krediteve dedikuar praktikës profesionale.
2. Institucioni, të reflektojë rezultatet e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e mësimdhënies, në Raportin Vjetor të njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi dhe të hartojë një plan masash për të promovuar rastet më të mira dhe për të adresuar problemet e ngritura.
3. Institucioni, të realizojë shpërndarjen e orëve në auditor së bashku me temat përkatëse për secilën orë, referuar secilës nga kategorive përkatëse, në leksion, seminar, laborator dhe detyrë kursi.
4. Institucioni, të bejë përpjekje për rekrutimin dhe shtimin e numrit të personelit akademik të kategorisë Profesor, në funksion të këtij programi studimi.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “Bedër”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

